



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **49**

Prishtinë, më 3.2.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH dhe ministri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 30.01.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për qendrën historike të Prizrenit,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.1.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.1.2012.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Prizrenin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe ministrin e MMPH dhe propozoi vazhdimin e punës së komisionit rreth projektligjit për QHP. Gjatë këtij takimi anëtarët e komisionit shqyrtuan nenin 16 të këtij projektligji, që ka të bëjë për Këshillin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Pas një diskutimi të gjerë të anëtarëve të komisionit rreth këtij neni, u tha se neni 16 është pika më diskriminuese në këtë projektligj, duke supozuar se mund të ketë çështje antikushtetuese. Më tej u theksua se vendimi i Presidentes së Kosovës është që të përfshihen edhe kultet tjera fetare.

Në këtë takim mori pjesë ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **Dardan Gashi**, i cili dha sqarime të shumta para anëtarëve të komisionit, ndërsa theksoi se në kreun e tretë të projektligjit ka disa propozime për ndryshime, të cilat janë më shumë çështje teknike. Sa i përket këshillit në përgjithësi dhe përfaqësimit në këtë këshill, ministri tha se Qeveria konsideron se ky ligj ka dalë nga Pakoja e Ahtisarit, andaj duhet t'i përmbahet pakos. Në këtë rast, shtoi ministri Gashi, përfaqësimi i Kishës Ortodokse serbe në Kosovë, ka qenë njëri nga kushtet themelore, ndërsa më vonë është vendosur që pjesë e kësaj të jetë edhe Bashkësia Islame dhe Kisha Katolike, për ta krijuar këtë baraspeshë. Ai shtoi se Qeveria me siguri nuk do të jetë kundër ndaj vendimit të Presidencës së Kosovës që pjesë e ligjit të jenë edhe bashkësitë tjera fetare.

Anëtarët e Komisionit unanimisht u dakorduan që në nenin 16 të këtij projektligji të mos jetë Kisha ortodokse serbe në Kosovë, por vetëm Kisha Ortodokse.

Pasi që u diskutua rreth kreut 3, përkatësisht **Nenit 16**, komisioni vendosi me vota **3 me 3** për ndryshimin e propozuar për të fshirë nënparagrafin 1.2 me pikat si dhe nënparagrafin 1.3 dhe paragrafin 6 (pa përkrahjen e Qeverisë). Kjo situatë u sqarua nga z. **Xheladin Hoxha** i cili konstatoi se propozimi nuk kalon në këto raste kur votohet barabartë.

Duke pasur parasysh kohën e shpenzuar për konsultime, kryetari me pajtimin e komisionit, caktoi mbledhjen e radhës të martën, kur fillimisht në orën 11,00 do të startohet me mbledhjen e përbashkët me komisionin për buxhet, pastaj do të vazhdoi komisioni me shqyrtimin e këtij projektligji.

Neni 16 mbetet si në projektligj, ndërsa Kryetari i Komisionit theksoi se në emrin e tij personal si deputet do të parashtroi amendament lidhur me Nenin 16 për të cilin do të deklarohet ky komision si dhe mbledhja plenare.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani